



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
»**HIDROREGJIONI JUGOR**« SH.A.D.D.
Nr. 4800
Dt. 26.11. 2025
PRIZREN

RAPORT – TM3 2025

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

Njesia Org. 0113 Nr. Prof. 4436
Org. Jedin Br. Prof.
Org Unit Prof.No:
Nr. i faqeve Datum: 27-11.25
Broj stranica Date:
No. pages Date:

PRISHTINE/A NO.1

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

Përmbajtje

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE	3
I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	4
1.1 Aktivitetet kryesore	4
1.2 Të arriturat kryesore.....	5
1.3 Problemet që kanë ndikuar në realizimin e objektivave.....	5
1.4 Masat e propozuara	7
2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	10
2.1 Situata e furnizimit	10
2.2 Prodhimi.....	11
2.3 Aktivitetet kryesore	12
2.3 Cilësia e ujit	13
3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	15
3.1 Numri i konsumatorëve	15
3.2 Faturimi m ³	16
3.4 Inspektimi dhe Shkyçja	17
4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE	18
4.1 Aktivitetet kryesore	18
4.2 Faturimi €.....	19
4.3 Arkëtimi €	20
4.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve	21
4.5 Transaksionet kryesore	22
5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA	23
5.1 Aktivitetet e përgjithshme	23
5.2 Statusi i projektit, Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit- Faza V dhe VI	

VI.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	29
6.1	Aktivitetet kryesore	29
VII.	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	32
8.1	PERFORMANCAT KRYESORE – TM1- TM2-TM3- 2025.....	32
8.2	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM2-TM3- 2025	33
8.4	REALIZIMI I CAQEVE - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” – TM3-2025	34
8.5	RAPORTI FINANCIAR - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” – TM3-2025	35
VIII.	ORGANOGRAMI	36

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjetësit, viti 2023



Punoi: Shërbimi TEKNIK

LEGJENDA	
05	Zona e shërbimit
06	Kopërcim me ujë
07	Kopërcim me ujë që ka instaluar një shtetë
08	Instalimet me shërbime të ujësjetësit

I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

1.1 Aktivitetet kryesore

- Monitorimin e burimeve te ujit
- Monitorimin e stacioneve te pompimit
- Evidentimin dhe rregullimin e defekteve
- Evidentimin dhe shkycjen e lidhjeve ilegale
- Përfundimin sa me te shpejte te projekteve kapitale (Me mjete vetanake)
- Monitorimin te projekteve kapitale te filluara (Nga Kuvendi Komuanl)
- Takimet e rregullta të menaxhmentit
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorët ekonomik, me konsumatorë, palë tjera të interest, etj.
- ARRU – Aplikimi tarifor
- SHUKOS – Diskutimi i problemit të energjisë elektrike
- Takime me Donatorë: në kuadër të projektit për "Rritjen e Reziliencës ndaj Ndryshimeve Klimatike në Sektorin e Ujit në Kosovë"
- Organizim i takimeve me komunat (Prizren, Suhareke, Dragash dhe Malisheve)
- Trajtimi i problemit te kaperderdhjes e ujit nga rezervuarët.
- Shtimi i masave te sigurise, vizita me te shpeshta ne burimet e ujit dhe raportimi per gjendjen e burimeve.
- Plotësimi i formularit për Aplikimin Tarifor 2026-2028.
- Takime të rregullta me punëtorët e shërbimeve te ndryshme. Shprehje e pakënaqësisë për pagat.
- Monitorim i implementimit te platformes per Operim dhe Mirembajtje MMS.
- Implementimi i "Plani i Veprimit per UPF 2025".
- Marrëveshje bashkëfinancimi me Komunën për rrjetin e ujësjellësit.
- Vazhdimi i implementimit te projektit UoF me Bankën Botërore,
- Takim me perfaqësues të lagjeve dhe komiteteve për zgjidhjen e problemeve rreth furnizimit me ujë.

Investime dhe Projekte, në process dhe të realizuara:

- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e pusetave jashtë pronës private, në rr. "Xheme Gostivari" – Prizren.
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e pusetave jashtë pronës private, në rr. "Imer Krasniqi" – Malishvë.
- Ndërtimi i objektit të Klorinatorit tek 40-Burimet.
- Rehabilitimi i kaptazhes IV tek 40-Burimet për shtimin e kapaciteteve të ujit.
- Integrimi i burimit alternativ ne fshatin Doberdolan - Suharekë

1.2 Të arriturat kryesore

TM2-TM3 -2025

- Rritja e aktiviteteve te ekipeve te inspektoratit;
 - Shkyçje të lidhjeve ilegale: **463**
 - Shkyçje për mos pagesë: **950**
 - Shkyçje totale: **1,417**
 - Riprogramime te borgjit: **47**
 - Bllombime të ujëmatësve: **1,054**
 - Raste te përmbaresit privat: **90**

- Prodhimi – m3 për +2.7% (+252,252 m3)
- Faturimi – m3 për +27.3% (+559,485 m3)
- Faturimi - € për +22.1% (+324,758.13 €)
- Arkëtimet -€ për + 52.0% (+710,298.91€)
- % e Arkëtimit ; +22.7% (716%)
- Numri i konsumatorëve ; +1.1% (+631)
- Shpenzimet -€ për + 24.0% (+334,968.07€)
- UPF; -5.3% (nga 77.8 % në + 72.5%)
- Mbulimi operativ ; 1.20 (nga 0.98)
- Mbulimi operativ €; +344,364.76 €

REALIZIMI I CAQEVE TM3 2025

- Prodhimi - m3 - 110.9 %
- Faturimi - m3 - 94.31 %
- Faturimi - € - 95.39 %
- Arkëtimit -€ - 116.02 %
- % e arkëtimit - 121.90 %
- Numri i konsumatorëve – 100.26 %
- Shpenzimeve- €- 90.90%
- Mbulimi operativ - 105.45%
- UPF - % 159.90%

1.3 Problemet që kanë ndikuar në realizimin e objektivave

- Rënia e nivelit të burimeve ne disa zona te caktuara sidomos ne Prizren, Malishevë dhe disa fshatra te Suharekës
- Reduktimet ne zona te caktuara

- Defektet e shumta në rrjet.
- Vonesat ne proceduat e prokurimit
- Keqpërdorimet e ujit
- Numri i orëve jashtë orarit, ne veçanti nga shërbimi i operatives. (si pasoje edhe e reduktimeve dhe numrit të madhe të defekteve)
- Mungesa e ndarjes se zonave te furnizimit dhe zonave te presionit
- Numri i madhe i konsumatorëve pa konsum. (Shtëpi dhe banesa te pa banuara)
- Numri i madhe i ujëmatësve me te vjetër se pese vite.
- Mos plotësimi i vendeve te punës për pozitat me ushtrues detyre.
- Mos zgjidhja e problemit te objektit të administratës
- Amortizimi i makinerisë se vjetër te punës
- Mos pagesa e obligimeve nga Kuvendet Komunale
- Rritja e çmimeve te energjisë elektrike
- Vonesa e fillimit te investimeve nga KK
- Rritje e kërkesës për ujë gjatë muajve të verës për shkak të temperaturave të larta dhe pranisë së diasporës, që ka shkaktuar presion të ulët dhe nevojë për reduktime në furnizim.
- Keqpërdorim i ujit të pijshëm për qëllime të tjera (bujqësi, larje rrugësh, ujitje hapësirash gjelbëruese), duke ndikuar në mungesë të ujit në disa zona.
- Humbje të konsiderueshme të ujit për shkak të amortizimit të rrjetit dhe defekteve të shpeshta në gypat primarë e sekundarë.
- Probleme me cilësinë e ujit në disa burime (sidomos në puse të reja), me turbullirë dhe përqendrim të lartë të manganit.
- Probleme me tensionin e ulët të energjisë elektrike, që ndikon negativisht në funksionimin e pompave dhe stacioneve të furnizimit.
- Mungesë e automjeteve dhe veglave të nevojshme për ekipet teknike, duke vështirësuar mirëmbajtjen dhe reagimin në kohë.
- Vështirësi në inkasimin e borxheve për shkak të mosinteresimit të konsumatorëve dhe numrit të lartë të lidhjeve ilegale.
- Numër i madh ujëmatësish të dëmtuar ose të pa pllombuar dhe mungesë e një ekipi të specializuar për ndërrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Mungesë e mbështetjes nga komunat për projekte infrastrukturore dhe koordinim të dobët ndërinstytucional.

- Një pjesë e konsiderueshme e borxheve i përket institucioneve publike dhe përdoruesve të mëdhenj.
- Në shumë raste, borxhet e konsumatorëve të mëparshëm mbeten të pashlyera dhe i bien mbi blerësit e rinj të pronave.
- Mungesa e një procedure ligjore të qartë për transferimin e detyrimeve sjell konflikte dhe kontestime nga pronarët e rinj.
- Një numër i madh ujëmatësish janë të amortizuar dhe me saktësi të dobët në matje.
- Kjo ndikon në:
 - Faturim jo të saktë (në dëm të ndërmarrjes),
 - Rritjen e kontestimeve,

Konsumatorët në emigracion dhe ndikimi i konsumit sezonal:

- **Problematika me konsumatorët socialë dhe ata me të ardhura të dobëta financiare:**

- **Mosrealizimi:** Kjo është një problematikë që ka mbetur pa zgjidhje efektive, pasi nuk janë gjetur mundësi të mjaftueshme për të adresuar borxhet e konsumatorëve socialë me të ardhura të dobëta.
- **Shkyqja e konsumatorëve që janë dërguar tek përmbaruesi privat pas periudhës së dërgimit të lëndës:**
- Shkyqja e konsumatorëve që nuk kanë paguar pas periudhës së dërgimit të lëndës tek përmbaruesi ka mbetur e pezulluar për disa konsumatorë, pasi ka pasur vështirësi në menaxhimin e këtyre rasteve dhe në mbikëqyrjen e shkyqjeve.

1.4 Masat e propozuara

- Zbatim i planit të veprimit për zvogëlimin e UPF-se
- Zbatimi i plotei MMS-sit
- Perfundimi i projekteve kapitale të inicuar
- Perfundimi i procedurave të prokurimit
- Pajisja me mjete të punës (eskavator, kamionet etj)
- Funkcionalizimi i plotei të qendrës së thirrjeve (24 ore)
- Vazhdimi i bllombimit të ujëmatësve.
- Rifreskimi i të dhënave të konsumatorëve.
- Identifikimi dhe dorëzimi i faturave tek konsumatorët edhe në formë elektronike.
- Riorganizimi i shërbimit të operativës
- Rishikimi i nivelizimit të pagave dhe përshkrimit të vendeve të punës
- Forcimi i sektorit për zvogëlimin e humbjeve të ujit
- Rritja e disiplinës në punë
- Rritja e efikasitetit të punës
- Përfundimi i projekteve me prioritet, rehabilitimin e burimeve ekzistuese dhe zvogëlimin e humbjeve teknike
- Funkcionalizimi i plotei të sistemeve të komunikimit (në burime dhe rezervuar)
- Përgatitja e rregulloreve për angazhimin e praktikanteve me kompenzim
- Plotësimi i standardeve të shërbimeve
- Rritja e aktiviteteve të shërbimit të ndërrimit të ujëmatësve
- Rritja e aktiviteteve në shkyqjen e konsumatorëve ilegal, shkyqjeve për mos pagesë dhe dërgimit të rasteve tek përmbaruesit privat
- Përgatitja e kampanjës për sensibilizimin e konsumatorëve për kursimin e ujit, rëndësinë e ujit, si dhe kryerjen e obligimeve ndaj kompanisë
- Rregullim i të gjitha defekteve në rrjetin primar dhe sekondar menjëherë pas paraqitjes, për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë.
- Mirëmbajtje e rregullt e stacioneve të pompave, rezervuarëve, kaptazhave dhe rrjetit të kanalizimeve.
- Përmirësim i cilësisë së ujit përmes analizave të rregullta dhe ndërhyrjeve në burime problematike.

- Ulje e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit përmes detektimit të rrjedhjeve dhe kontrollit të vazhdueshëm të rrjetit.
- Parandalim i keqpërdorimeve të ujit të pijshëm përmes inspektimeve dhe ndërhyrjeve administrative.
- Kursim i energjisë elektrike përmes optimizimit të pompimit pa dëmtuar furnizimin.
- Rritje e angazhimit për inkasimin e borxheve, përmes shkyçjeve, marrëveshjeve për riprogramim dhe përmbarimit ligjor.
- Vendosje e ujëmatësve zonal dhe ndërrim i atyre të dëmtuar për matje më të sakta dhe ulje të ujit të pafaturuar.
- Furnizim i njësive me pajisje dhe automjete të reja për operim më efikas në terren.
- Bashkëpunim më i ngushtë me komunat dhe KEDS për zgjidhjen e çështjeve të infrastrukturës dhe energjisë elektrike.

Infrastrukturë dhe Investime

- Vazhdimi i projekteve për rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe zgjidhjen afatgjatë të defekteve kronike (Rr. "Bingenit" në Prizren).
- Zgjerim i rrjetit dhe ndërrim i gypave në vendbanime të ndryshme (Bllacë, Greikoc, Sopijë, Studenqan).
- Intensifikim i detektimit të rrjetit dhe vendosja e ujëmatësve të mençur.

Përmirësime Operative dhe Monitorim

- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore.
 - Azhurimi i sistemit MMS dhe përmirësimi i menaxhimit të të dhënave.
 - Takime të rregullta koordinuese për menaxhimin efikas të operacioneve.
- **Zarfimi i faturave për mbrojtjen e të dhënave personale:**
- Vazhdimi i praktikës së zarfimit të faturave për konsumatorët, me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale sipas udhëzimeve nga Agjencia për Informim dhe Privatësinë. Zarfimi do të realizohet nga lexuesit gjatë periudhës së leximit.
- **Identifikimi i konsumatorëve pa ujëmatës që nuk kanë reaguar ndaj njoftimeve për vendosjen e ujëmatësve:**
 - Identifikimi i konsumatorëve që ende nuk kanë vendosur ujëmatës dhe nuk janë përgjigjur ndaj njoftimeve për instalimin e tyre. Pas identifikimit, do të vazhdohet me shkyqjen e tyre nga shërbimi.
- **Vizita tek institucionet që nuk kanë bërë pagesat e shërbimit:**
- Vizita tek institucionet që kanë borxhe të papaguara për shërbimet e ujësjellësit me qëllim inkasimin e këtyre borxheve.
- **Intensifikimi i kontrolleve rutinore dhe të planifikuara:**
- Intensifikimi i kontrolleve rutinore dhe të planifikuara për konsumatorët, në terrenet e lexuesve çdo muaj.
- **Vizita dhe trysni për konsumatorët që nuk kanë paguar faturat për më shumë se 1 vjet:**

- **Thirrje dhe mesazhe për konsumatorët që nuk i përmbahen kontratës:**
 - Vazhdimi i thirrjeve telefonike dhe dërgimi i mesazheve për konsumatorët që nuk i përmbahen kontratës për pagesën e faturave.

- **Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në terren:**
 - Shpërndarja e paralajmërimeve për konsumatorët që nuk i kanë përmbushur detyrimet e pagesës para inicimit të procedurave përbarimore.

- **Vizita më të shpeshta tek konsumatorët e bizneseve që kanë borxhe:**
 - Vizita më të shpeshta tek konsumatorët e bizneseve që kanë borxhe dhe nuk i përmbahen pagesave të kësteve të kontratës.

- **Monitorim dhe kontroll i vazhdueshëm i lexuesve:**
 - Vazhdimi i monitorimit dhe kontrollit të lexuesve për të siguruar që ata të zbatojnë procedurat e leximit në mënyrë efikase dhe të ndërrohen metodat e leximit në terren.

- **Regjistrimi dhe legalizimi i konsumatorëve të rinj:**
 - Vazhdimi i procesit të regjistrimit dhe legalizimit të konsumatorëve që shfrytëzojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

- **Raportimi në kohë reale për ujëmatësat jo-funksional dhe rrjedhjet:**
 - Lexuesit do të vazhdojnë të raportojnë në kohë reale për ujëmatësat jo-funksional dhe për rrjedhjet që hasin gjatë leximit, si dhe do të raportojnë për keqpërdoruesit e ujit.

- **Bllombimi i ujëmatësve:**
 - Vazhdimi i bllombimit të ujëmatësve me një intensitet më të lartë për të parandaluar keqpërdorimin.

2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

2.1 Situata e furnizimit

Gjatë muajve Korrik-Shtator 2025, furnizimi me ujë të pijshëm në nivel regional ka qenë kryesisht i rregullt, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese dhe operuese. Megjithatë, në disa zona janë shfaqur reduktime dhe rënie të presionit, sidomos në zonat më të larta. Këto vështirësi kanë ardhur si pasojë e uljes së niveleve të ujit në burime, kushteve të pafavorshme gjeografike si dhe infrastrukturës së vjetruar të rrjetit shpërndarës.

Në krahasim me muajt paraprakë, furnizimi gjatë muajve Korrik-Shtator, duke filluar nga nga fundi i muajit Korrik ka rezultuar më pak i qëndrueshëm, duke paraqitur vështirësi në përmbushjen e standardit optimal për furnizim 24-orësh dhe me cilësi të plotë të ujit të pijshëm. Pavarësisht masave të ndërmarra për operim, mirëmbajtje dhe monitorim të vazhdueshëm, janë hasur sfida të ndryshme në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm.

Reduktimet dhe mungesat e furnizimit, të cilat nisën në fund të muajit Korrik, kanë vazhduar edhe gjatë muajve Gusht dhe Shtator. Këto kanë prekur disa lagje të qytetit të Prizrenit (Abana, Bajram Curri dhe Ortakolli), fshatin Zhur si zonë e vetme periferike, si dhe disa zona në njësitë e Malishevës dhe Suharekës. Shkaqet kryesore lidhen me rritjen e kërkesës për ujë, rënien e nivelit të burimeve dhe defektet e rrjetit shpërndarës.

Kompania ka vazhduar të zbatojë masa për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës hidroteknike dhe elektro-mekanike, duke synuar sigurimin e një furnizimi sa më të qëndrueshëm dhe cilësor për konsumatorët. Paralelisht, janë intensifikuar përpjekjet për investime kapitale që synojnë ofrimin e zgjidhjeve afatgjata për problemet teknike, rehabilitimin e infrastrukturës së vjetruar dhe menaxhimin më efikas të burimeve ujore në kushtet klimatike aktuale.

NJ.P- Prizren

*Furnizimi me ujë: Nuk ka qenë i qëndrueshëm në krahasim me muajt paraprak si pasojë e rënies së nivelit të ujit në burimet kryesore. Reduktimet janë duke vazhduar të aplikohet në disa lagje të qytetit të Prizrenit si dhe në fshatin Zhur si zonë e vetme periferike.

NJ.P Suharekë

Gjatë muajve Korrik-Shtator 2025, furnizimi me ujë ka qenë i qëndrueshëm. Megjithatë me rritjen e temperaturave, është vërejtur një rritje e ndjeshme e kërkesës për ujë. Gjatë kësaj periudhe, uji nuk është përdorur vetëm për nevoja bazë, por është keqpërdorur në forma të ndryshme, gjë që ka ndikuar negativisht në furnizim. Për të siguruar një shpërndarje më të drejtë dhe të barabartë të ujit në tërë zonën e shërbimit, kemi qenë të detyruar të aplikojmë reduktime të kontrolluara sipas një orari të caktuar.

NJ.P- Malishevë


* Furnizimi me ujë nuk ka qenë i mire në muajit Korrik-Shtator në të gjithë zonën e shërbimit ku ne operojmë, pikat e larta përsëri kemi problem sikurse muajt paraprak. Këtu vlen të ceket disa lagje të fshatit Drenoc dhe disa lagje të fshatit Carralluk, fshati Lladroc, fshati Bellanic, Turjak. Ky mosfurnizim ka ardhur si rezultat i rënjes së burimeve të ujit në këto lokalitete.

NJ.P- Dragash

* Gjatë muajve Korrik-Shtator, furnizimi me ujë në përgjithësi ka qenë i rregullt, këtë situatë stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhur, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave, eliminimin e defekteve në gypat e ujësllësit, dhe punë të tjera (pastrime) në kaptazhë në fshatin Radeshë.

2.2 Prodhimi

TM1-TM2-TM3- 2025						
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN						
PRODHIMI - m3						
NJËSIA PUNUESE	TM1-2025		TM2-2025		TM3-2025	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	796.9	6,196,505	908.7	7,144,709	946.6	7,442,443
SUHAREKË	146.7	1,140,375	152.4	1,198,481	150.1	1,180,530
MALISHEVË	78.1	607,639	88.0	691,908	81.5	640,525
DRAGASH	25.3	196,524	25.9	203,262	28.9	227,114
TOTAL	1,046.9	8,141,043	1,175.0	9,238,360	1,207.1	9,490,612
NDRYSHIMI l/sec			34.80	1,097,317	32.08	252,252
NDRYSHIMI %				13.48%		2.73%



*Gjatë pjesës së fundit të muajit Korrik 2025, është evidentuar një rënie e prodhimit të ujit në nivel regional në komunat Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash. Ky rezultat përbën një tregues të drejtpërdrejtë të rënies së nivelit të burimeve ujore, gjë që ka ndikuar në realizimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë. Përveç kësaj, defektet e shpeshta dhe amortizimi i rrjetit

shpërndarës kanë kontribuar në humbje të konsiderueshme, duke ulur efikasitetin e përgjithshëm.


Nga ana tjetër, niveli i lartë i defekteve në rrjet dhe amortizimi i rrjetit ekzistues vazhdojnë të kenë ndikim negativ, duke kontribuar si në rritjen artificiale të kërkesës për prodhim, ashtu edhe në humbje të konsiderueshme të ujit gjatë shpërndarjes.

Ky kombinim faktorësh evidenton nevojën për investime të vazhdueshme në rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit, në mënyrë që prodhimi i shtuar të shoqërohet me efikasitet më të lartë dhe humbje më të ulëta.

2.3 Aktivitetet kryesore

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve – TM3- 2025

Njësia Operative	Ujësjetlësi - uji i pijes
Prizren	431
Suharekë	90
Dragash	26
Malishevë	59
Total	606



* Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në tabelë.


Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti i Ujit të Pijes (DUP)		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Korrik-Shtator, 2025	
Kalibrim i ujëmatësave	75	riparime të ujëmatësave
Ndërrimi i ujëmatësave (D-M)	558	vizita të konsumatorit
	350	ndërrime të ujëmatësave
	108	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	216	detektive
	140	defekte të gjetura
	10,940	rrjet i detektuar (m)

2.3 Cilësia e ujit

- Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në Qytet ,si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
- Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
- Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit per te percjellur punen e procesit të klorinimit dhe paisjeve.
- Marrja e mostrave sipas Planit per monitorim te cilesis se ujit.
- Vazhduan punimet në ndertimin e objektit te stacionit te klorinimit në „40-Burime”.
- Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
- Ishim në Prishtinë në ShUKOS ,për ta finalizau Planin e siguris së ujit,
- Ishim per vizit në fabrikën e re të ndërtuar në Dragash
- Pjesemarrje në Workshopin „TAIEX Workshop on the EU standards and legislation covering dring water.

Rezultata e analizave nga IKSHP – TM3-2025

NJËSIA	LLOJI I UJIT	NR. I MOSTRAVE	NUK I PËRGJIGJEN
PRIZREN	Ujësjiellës	426	0
SUHAREKË	Ujësjiellës	68	0
MALISHEVË	Ujësjiellës	60	0
DRAGASH	Ujësjiellës	32	0
TOTAL	Ujësjiellës	586	0



Rezultata e analizave nga Laboratori - KRU – TM3-2025

TM-3	Lloji furnizimit	Mostra Totali	Bakterologjike			Fiziko-Kimike		
			Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet	Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet
Korrik 2025	Burim	56	28	6	22	28	24	4
	Rrjet	128	64	64	0	64	64	0
Gusht 2025	Burim	58	28	11	17	30	30	0
	Rrjet	116	58	58	0	58	58	0
Shtator 2025	Burim	56	28	14	14	28	26	2
	Rrjet	92	46	46	0	46	46	0
Total	Burim	170	84	31	53	86	80	6
	Rrjet	336	168	168	0	168	168	0


3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.1 Numri i konsumatorëve

TM1-TM2-TM3- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A – PRIZREN

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA				
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2-2025	TM3-2025
1	Shtëpiak	55,663	56,240	56,879
2	Ndryshimi		577	639
3	Ndryshi. %		1.04%	1.14%
4	Kome.-Indu.	6,989	7,040	7,113
5	Ndryshimi		51	73
6	Ndryshi. %		0.73%	1.04%
7	Institucional	346	349	353
8	Ndryshimi		3	4
9	Ndryshi. %		0.87%	1.15%
10	TOTAL	62,998	63,629	64,345
11	Ndryshimi		631	716
12	Ndryshi. %		1.00%	1.13%




3.2 Faturimi m3

TM1-TM2-TM3- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

FATURIMI - m3				
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025	TM3- 2025
1	Shtëpiak	1,565,607	1,711,690	2,217,532
2	Ndryshimi		146,083	505,842
3	Ndry. %		9.3	29.6
4	Kome.-Indu.	203,820	199,526	241,123
5	Ndryshimi		(4,294)	41,597
6	Ndry. %		(2.1)	20.8
7	Institucional	121,741	159,751	151,679
8	Ndryshimi		38,010	(8,072)
9	Ndry. %		31.2	(5.1)
10	TOTAL	1,891,168	2,070,967	2,610,334
11	Ndryshimi		179,799	539,367
12	Ndry. %		9.5%	26.0%



3.3 Ankesat teknike dhe komerciale

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre

TM3-2025 HRJ

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	950
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	525
1.2 Mungese e ujit	numër	386
1.3 Rënie e presionit	numër	14
1.4 Cilësia e ujit	numër	3
1.5 Të tjera	numër	24
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	271
2.1 Kontestim i borxhit, faturës	numër	173
2.2 Verifikim i leximit të ujëmatësimit /te tjera	numër	87
2.3 Te tjera	numër	11

3.4 Inspektimi dhe Shkyçja

Me intensitet të shtuar, kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, ku janë shpërndarë vërejtje për ndërprerje të shërbimit inspektive verifikime dhe shkyçje për mos pagesë, lidhjeve ilegale, legalizim të konsumatorëve, ankesa të konsumatorëve, arkëtimin e borjeve dhe aktivitete të tjera.

Me prioritet janë proceduar rastet e konsumatorëve që kanë borje mbi 200€ dhe që praparakisht nuk u janë përgjigjur vërejtjeve paralajmëruese për shkyçje

- Këto aktivitete mund të shihen në tabelën vijuese:

• RAPORT I EKIPEVE TË INPEKTORIATIT – TM3 2025

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmëruese për përmbarim/shkyçje	Shkyçjet - Lidhjet e paligjshme	Shkyçjet për mos pagesë	Nr. i shkyçjeve Totale	Verifikimi i leximit të ujëmatësimit	Rastet e dorezuara për gjykatë	Rastet e dorezuara për përmbaruesit	Kontrata të riprogramimit
Prizren	10,235	380	689	1,069	2,368	14	48	23
Suharekë	3808	60	230	290	1,639	2	35	15
Malishevë	11	17	24	41	872	1	7	9
Dragash	31	10	7	17	301	0	2	0
TOTAL	14,085	463	950	1,417	5113	17	90	47

4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE

4.1 Aktivitetet kryesore


Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performancë sa më të mirë të kompanisë.

- Punët ditore të zakonshme, si regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.
- Përgatitja e raporteve mujore e tre muroje për institucionet përkatëse, si ARRU, ASK, ME etj.
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajin përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve.
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre për blerje dhe shpërndarja e materialit të blerë;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo arken kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorëve, pagesat e rregullta, sipas blerjeve;
- Regjistrimi i investimeve kapitale si dhe raportimi i tyre;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Plotësimin e librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesës nga ATK, për muajin përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Në këtë tremujor, jemi subjekt kontrolli nga inspektorët tatimorë në ATK për vitet 2022-2024, të cilët vazhdojnë punën ende;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë, lidhur me performancën dhe prezantimin e rekomandimeve për aktivitete të tjera për performancë më të mirë të kompanisë;

4.2 Faturimi €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN
TM1-TM2- TM3-2025

FATURIMI - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025	TM3- 2025
1	Faturimi-€	1,345,043.32	1,456,526.71	1,775,303.93
2	Total- Shte.	1,032,769.40	1,112,766.91	1,388,453.55
3	Ndryshimi	(25,404.95)	79,997.51	355,684.15
4	Ndry. %	(0.07)	7.7%	34.4%
5	Total- kome.	201,778.24	208,923.00	262,880.14
6	Ndryshimi		7,144.76	61,101.90
7	Ndry. %		3.5%	30.3%
8	Total-Inst.	110,495.68	134,836.80	123,970.24
9	Ndryshimi		24,341.12	13,474.56
10	Ndry. %		22.0%	12.2%
11	Te tjera	6,920.91	9,877.63	15,858.54
12	Total	1,351,964.23	1,466,404.34	1,791,162.47
13	Ndryshimi		114,440.11	439,198.24
14	Ndry. %		8.5%	32.5%




4.3 Arkëtimi € .

TM1-TM2 -TM3- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN


No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025	TM3- 2025
1	Total- Shtëpiak	1,003,333.19	1,044,431.10	1,641,164.88
2	Ndryshimi		41,097.91	596,733.78
3	Ndry. %		4.1%	57.1%
4	Total-Komercial-Industrial	201,866.62	200,936.17	316,219.10
5	Ndryshimi		(930.45)	115,282.93
6	Ndry. %		-0.5%	57.4%
7	Total Institucional	115,533.20	114,547.97	104,249.35
8	Ndryshimi		(985.23)	(10,298.62)
9	Ndry. %		-0.9%	-9.0%
10	Total - ujë	1,320,733.01	1,359,915.24	2,061,633.33
11	Ndryshimi		39,182.23	701,718.09
12	Ndry. %		3.0%	51.6%
13	Te tjera	4,996.51	6,866.80	15,448.60
14	Ndryshimi		1,870.29	8,581.80
15	Ndry. %		37.4%	125.0%
16	TOTAL	1,325,729.52	1,366,782.04	2,077,081.93
17	Ndryshimi		41,052.52	710,299.89
18	Ndry. %		3.10%	51.97%



4.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN
TM1-TM2- TM3- 2025

SHPENZIMET - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025	TM3- 2025
1	Total Shpenzimet Operative	1,247,049.45	1,405,689.76	1,734,717.19
2	Pagat	781,851.45	808,876	831,009
3	Rryma elektrike	268,928.48	390,109	638,772
4	Shpen. e derivateve	29,720.60	23,598	30,098
5	Mirem. dhe riparimet	72,240.61	67,548	97,806
6	Mirem. e automjeteve	8,262.46	30,746	34,011
7	Shpen.e taksave	26,419.15	27,679	27,491
8	Kemikaliet	6,146.09	3,905	5,080
9	Shpenzimet e tjera	53,480.61	53,228	70,451
10	Ndryshimi		158,640.31	329,027.43
11	Ndryshimi ne %		12.72%	23.41%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e III-të 2025, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të II-të 2025 janë për 23.4 % më të larta;
Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi një rritje të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e kaluar për 0.03 %, kemi rritje të numrit të punëtorëve, ku në këtë tremujor janë punësuar 8 punëtorë, si dhe angazhimi i punëtorëve ka qenë më i lartë, që ka ndikuar në orë pune shtesë. Pra, kjo ka ndikuar direkt në rritjen e shpenzimeve të pagave për këtë tre mujor;

Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, sipas vlerës, kemi rritjen me të madhe për këtë tremujor, për shkak se në qershor, me energji elektrike, jemi furnizuar dhe faturuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) KEK-u dhe me këtë rast ka ndryshuar edhe cmimi i energjisë, në krahasim me tremujorin e II-të, pra rritja vetëm për këtë tremujor është 63%;

Rritje kemi edhe te shpenzimet e derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, pra përveç rritjes së çmimit të derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, kemi rritje edhe të hargjimit, për shkak se ekipet e terrenit kanë qenë më aktive në punën e tyre;

Gjithashtu rritje kemi edhe te shpenzimet e kategorisë së mirëmbajtjes në rrjet dhe në mirëmbajtjen e pompave. Pasi në këtë tremujor kemi pasur më shumë intervenime në rrjet, si dhe kemi pasur gjithashtu edhe ndërrime më shumë të ujëmatësave;

Rritje të kemi pasur te shpenzimet e pozicionit të mirëmbajtjes së automjeteve, pothuajse në të gjitha njësitë, pasi që tremujorin e kaluar kemi pasur më pak riparime. Vlenë të theksohet se, vjetërsia e makinerisë ka ndikuar dukshëm në intervenime të pa planifikuara në makineri; Rënie të lehtë kemi pasur te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi pasur më pak lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e tjera jo pse kanë ndryshuar shumë, si ato të SHUKOS dhe të ARRU-së;

Ndërsa rritje të shpenzimeve kemi edhe tek shpenzimet e kategorisë të tjera, pra në këtë kategori ku përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve, gjithashtu këtu hyjnë edhe shpenzimet për veshëmbathje të punëtorët, ku në këtë tremujor, jemi furnizuar për veshëmbathje verore për të gjithë punëtorët e terrenit;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura me lartë.

4.5 Transaksionet kryesore

10 pagesat me të mëdha nga Hidroregjioni Jugor për Operatorët TM3- 2025

	Data	Nr. i dokumentit	Emri i operatorit	Shuma -€
1	9/4/2025	BPBPZNPOS-011255	KEK-u	250,528.22
2	9/26/2025	BPBPZNPOS-011357	KEK-u	227,116.77
3	8/1/2025	BPBPZNPOS-011124	KEK-u	210,191.65
4	8/1/2025	BPBPZNPOS-011120	Bojku Hidraulik	168,640.00
5	9/30/2025	TEB-SH-000005520	IDEAL SHALA B.I.	39,920.00
6	7/15/2025	BPBPZNPOS-011014	CO-ING Afrim S. Ibrahim	36,976.04
7	9/26/2025	TEB-SH-000005494	Xerxa Hidro Goup	36,790.00
8	8/25/2025	BPBPZNPOS-011209	CO-ING Afrim S. Ibrahim	25,399.68
9	7/9/2025	TEB-SH-000004975	Seykos sh.p.k.	23,545.00
10	7/7/2025	BPBPZNPOS-010973	4ING sh.p.k.	18,939.00
	TOTAL			1,038,046.36

10 pagesat me te mëdha ndaj Hidroregjioni Jugor për TM2- 2025

	Data	Nr. i dokumentit	Emri I operatorit	Shuma -€
1	27.08.2025	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	11,239.69
2	26.08.2025	KONS-0025465	Enver Shishko	10,785.92
3	29.09.2025	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	10,651.39
4	29.07.2025	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	8,724.02
